



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

STATUTI I KOLEGJIT “BIZNESI”

Prishtinë 2019

Kolegji BIZNESI është themeluar në vitin 2004, si institucion privat i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në Kosovë dhe me seli qendrore në Prishtinë. Kolegji është mbështetur në traditat dhe arritjet arsimore e shkencore më të përparuara të vendit dhe ato botërore. Deri tani Kolegji BIZNESI ka dhënë kontribute të shquara në fushën e arsimit të lartë në Kosovë, për të cilat është vlerësuar nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, si Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ky Statut përmban norma që rregullojnë veprimtarinë e Kolegjit BIZNESI, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në garantim të autonomisë bartësve të arsimit të lartë dhe të lirisë akademike, të mbrojtura nga ligji nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës; në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i Statutit

Ky Statut ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Institucionit, të strukturave përbërëse të tij; veprimtaritë e autoriteteve dhe të organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative; periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose të programeve të studimit; detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e Kolegjit BIZNESI.

Neni 2 Baza ligjore

Ky Statut bazohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, si edhe në aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Neni 3 Personaliteti juridik

1. Kolegji BIZNESI është person juridik privat, i njohur me ligj si i tillë.
2. Kolegji BIZNESI përdor akronimin KB.
3. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si edhe me rregullat e parashikuara në këtë Statut dhe në rregulloret e tij.
4. Njësitë përbërëse gëzojnë personalitet juridik, sipas kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga ky Statut.
5. Të gjitha mjediset (ndërtesa e troje) që ka në përdorim Kolegji BIZNESI, si dhe çdo mjedis i fituar në të ardhmen sipas ligjit, gëzojnë paprekshmërinë. Kjo paprekshmëri përfshin moslejimin e ndërhyrjes në mjediset e tij, apo të përdorimit të tyre nga çdo person fizik e juridik, mosndërhyrjen e pushtetit qendror e lokal dhe të organeve të rendit publik pa kërkesën dhe lejen e themeluesit/dekanit ose të personit të autorizuar prej tyre.
6. Përrjashtimisht, për rastet e kryerjes së një vepre penale flagrante dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e themeluesit / përgjegjësve të Programeve.
7. Për çdo cenim të paprekshmërisë, nga pika 5 e nenit 8, të këtij statuti, Kolegjit i lind e drejta e denoncimit të shkeljes, dëmshpërblimit dhe kërkimit të ndëshkimit të shkelësit sipas dispozitave ligjore.
8. Kolegji BIZNESI, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës, ka të drejtën për hapjen e degëve dhe njërive ndihmëse mësimore në komuna të tjera të Kosovës, si dhe në shtete të tjera, në fusha të ndryshme të formimit profesional shkencor.

Për hapjen e njësive të tilla, Kolegji respekton këto kritere:

- a) Sigurimi i sallave dhe anekseve të tjera ndihmëse për mësimdhënie të rregullt, në raport me numrin e studentëve, mbi bazën e standardeve të njohura;
- b) Sigurimi i mjeteve të mësimdhënies;
- c) Sigurimi i personelit akademik mësimdhënës të kualifikuar;
- d) Sigurimi i personelit administrativ;
- e) Mbajtje e dokumentacionit themelor në njësinë qendrore (Prishtinë);
- f) Zbatimi i planeve dhe programeve mësimore të miratuara në nivel të Kolegjit “BIZNESI”, në Prishtinë;
- g) Përpunimi i strukturës mësimore nga Programet në njësinë qendrore dhe monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit mësimor nga ana e njësisë qendrore;
- h) Sigurimi i kryerjes së punëve laboratorike dhe praktikave mësimore.

9. Kolegji kryen çdo vit vlerësimin e brendshëm të tij dhe kërkon akreditimin, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Neni 4 Misioni

Kolegji BIZNESI është bartës privat i arsimit të lartë që ofron disa programe të nivelit bachelor dhe master. Kolegji kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën. Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxisim rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale.

Këtë mision ai e realizon përmes këtyre synimeve:

- të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale, duke përmbushur të gjitha detyrat që rrjedhin nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës.
- të formojë studiues të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimet kryesore të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese;
- si promotor i formës më të lartë të arsimit, synon edhe përvetësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike për ta bërë individin jo vetëm specialist kompetent, por dhe një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.
- të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka Kosova;
- të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër e rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.

Neni 5 Vizioni

Kolegji BIZNESI synon të mbetet model si bartës i arsimit të lartë privat, i karakterizuar nga përgatitje rigorozë akademike dhe kërkim i thelluar shkencor, një institucion arsimor i zgjedhjes së parë për studentët e angazhuar në transformimin e jetës së tyre dhe të shoqërisë.

Neni 6 Parimet

1. Parimet nga të cilat udhëhiqet Kolegji BIZNESI janë:
 - a. Liria e mendimit dhe e shprehjes
 - b. Autonomia në mësimdhënie dhe kërkim shkencor
 - c. Transparenca
 - d. Meritokracia
 - e. Kolegjialiteti
 - ë. Mosdiskriminimi

Neni 7 Zhvillimi i veprimtarisë

1. Veprimtaria e Kolegjit BIZNESI organizohet dhe realizohet përmes njësive të tij përbërëse, si dhe nga organet dhe autoritetet drejtuese që veprojnë mbështetur në kompetencat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në këtë Statut, si dhe në rregulloret e tjera të Kolegjit.
2. Kolegji BIZNESI vendos në bazë të mësimdhënies traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira botërore e ato europiane.
3. Kolegji BIZNESI e zhvillon veprimtarinë e vet brenda sistemit universitar e të kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar në kuadër të detyrimeve me karakter integruar, apo në realizim të marrëveshjeve ndërkombëtare.
4. Kolegji BIZNESI konsideron detyrë themelore të mësuarit, studimit dhe kërkimit shkencor, në bashkëpunim me institucionet vendase dhe nëpërmjet shkëmbimit ndërkombëtar të pedagogëve e të studentëve, në përmbushje të objektivave dhe të programeve të veta.
5. Kolegji BIZNESI anëtarësohet në organizma të përhershme, si dhe aktivizohet në organizma dhe veprimtari të përkohshme të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në fushën përkatëse, brenda ose jashtë vendit.
6. Kolegji BIZNESI në përputhje me misionin e vet të mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe në respektim të lirisë së individit, harton programe e projekte të veçanta, sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurrin me këto projekte në planin kombëtar dhe ndërkombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor.
7. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet, Kolegji BIZNESI u krijon studentëve kushtet për përvetësimin e dijeve, shprehjen e lirë të mendimit e të organizimit, në respektim të kërkesave të bashkëjetesës, të ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe të Rregullores së Kolegjit BIZNESI.
8. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet, Kolegji BIZNESI u krijon studentëve me aftësi të kufizuara kushtet për të ndjekur të gjitha veprimtaritë mësimore, provimin e dijeve në përputhje me programin e studimit që ata po ndjekin, si dhe aksesin në biblioteka, salla kompjuterash, laboratorë, mjedise sportive dhe shërbime të tjera, që ofrohen për studentët nga

institucioni, në përputhje me një përshtatje të arsyeshme, e cila nuk duhet të përbëjë një barrë të tepruar financiare për Kolegjin.

9. Kolegji BIZNESI është institucion laik dhe i depolitizuar.

10. Kolegji BIZNESI, si person juridik, merr pjesë në veprimtaritë publike e private dhe në qarkullimin civil, brenda ose jashtë vendit, në ushtrim të funksioneve dhe në realizim të qëllimeve të tij të ligjshme.

11. Kolegji BIZNESI ka të drejtën e vendosjes së marrëdhënieve me Universitete të huaja me qëllim bashkëpunimi ndëruniversitarë e shkëmbimi të përvojave akademike, shkencore, realizimit të programeve të studimeve të përbashkëta për studentët, dhe shkëmbimin e kuadrove akademike, projekteve hulumtuese dhe botimeve të përbashkëta etj.

12. Kolegji ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata, organizata ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ai bashkëpunon me organizma joqeveritare të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Neni 8

Liria akademike, autonomia financiare dhe organizative

1. Kolegji BIZNESI gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës:

a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore e të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese, në përputhje me misionin dhe qëllimet e tij;

b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;

c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

3. Kolegji "BIZNESI" financohet nga themeluesi i tij. Ai ka të drejtë të krijojë e të përdorë të ardhurat që realizohen nga veprimtaria e tij dhe donacione të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autonomia financiare e tij garantohet nëpërmjet së drejtës:

a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) për të përfituar fonde nga pagesat e studentëve;

c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe të përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të Kolegjit;

ç) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

d) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të tij;

dh) për të krijuar, në përputhje me dinamikën e zhvillimit, institute, qendra, njësi shërbimi, njësi trajnimi etj., që gjenerojnë të ardhura, me statuse të ndryshme, në nivelin e degëve apo në nivel të Kolegjit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës:

a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe për të rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme të institucionit;

b) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me përcaktimet ligjore;

c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendës ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;

ç) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) për të vendosur marrëdhënie me institucione e organizata vendase apo të huaja, publike e jopublike, me organizata biznesi, Organizata jo fitimprurëse etj., lidhur me bashkëpunimin institucional, profesional e shkencor, për shkëmbimin e përvojave të personelit akademik, administrativ dhe të studentëve, për praktikat e studenteve, projekte të përbashkëta etj.

5. Veprimtaria e Kolegjit dhe e strukturave përbërëse të tij udhëhiqet nga parimi i kolegjalitetit, i transparencës dhe i meritës.

6. Kolegji "Biznesi" ka për detyrë të raportojë çdo vit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për aktivitetin mësimor, shkencor.

7. Themeluesi i Kolegjit "BIZNESI", personi i autorizuar nga ai ose dekani përfaqëson Kolegjin si person juridik dhe vepron në emër të tij, brenda kufijve të të drejtave që i njohin ligjet, ky Statut, aktet nënligjore dhe Rregulloret e Kolegjit.

Neni 9

Selitë qendrore dhe degëve

Selia qendrore e Kolegjit BIZNESI është në Prishtinë, Rr. "Motrat Qiriazit" nr. 29 Ulpianë, Prishtinë 10000; si dhe në Degën e Kolegjit në Gjakovë, Rr. Transit; në Degën e Kolegjit në Vushtrri, Rr. "Dëshmorët e Kombit" - Qendra e Mileniumit kati i I-rë; dhe me Degën e Kolegjit në Prizren, Rr. "JONI" nr.10 (përballë Stacionit të autobusëve).

Neni 10

Simbolet e Kolegjit dhe Vula zyrtare

1. Simbolet e Kolegjit BIZNESI përfshijnë stemën e Kolegjit dhe flamurin e Kolegjit.

2. Stema e Kolegjit BIZNESI miratohet nga Bordi i Kolegjit dhe vendoset në mjediset e administratës qendrore të Kolegjit BIZNESI, në zyrën e Dekanit, si edhe në sallën e mbledhjeve të Bordit dhe të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor.

3. Në komunikimin zyrtar shkresor vendoset stema e Kolegjit BIZNESI.

4. Flamuri i Kolegjit BIZNESI, vendoset në hyrje të Qendrës dhe degëve, si dhe me përmasa të vogla në mjediset e zyrave dhe të sallave të ligjëratave.

5. Kolegji BIZNESI ka vulën zyrtare të miratuar nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor. Vula ka diametrin 30 mm, me stemën BIZNESI në qendër dhe rreth saj shënohet: Kolegji BIZNESI. Të drejtën e përdorimit të vulës së Kolegjit e ka themeluesi, dekani dhe personi i autorizuar prej tij.

KREU II

ORGANIZIMI DHE STRUKTURAT PËRBËRËSE

Neni 11

Emërtimi i Institucionit

Institucioni ynë i Arsimit të lartë në Kosovë emërtohet: **Kolegji BIZNESI Shpk**

Neni 12

Drejtimi i institucionit

Drejtuuesi i Kolegjit është dekani. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i Kolegjit dhe përfaqësuesi i tij. Ai koordinon veprimtarinë e njësisve bazë dhe të organeve kolegjinale të Kolegjit dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.

Neni 13

Strukturat përbërëse të Kolegjit BIZNESI

1. Struktura organizative e Kolegjit BIZNESI është e ndarë në njësitë: menaxhuese, akademike, hulumtuese dhe mbështetëse.

Njësi më e lartë menaxhuese në Kolegjin BIZNESI është Bordi, i cili është përgjegjës për planifikimin, kontrollin dhe menaxhimin e aktivitetit.

Organ më i lartë akademik është Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor, me të cilin udhëheq Dekani. Në Këshill përfaqësohen të gjitha njësitë akademike dhe hulumtuese, sidhe përfaqësuesitë e studentëve.

Në kuadër të programeve krijohen këshillat mësimorë, me të cilët udhëheqin bartësitë e programeve.

Kolegji BIZNESI krijon komisionete punës siç janë:

- Komisioni për pranimin e studentëve,
- Komisioni për vlerësimin e angazhimit të stafit akademik,
- Komisioni për ekuivalencën e notave të plan-programeve,
- Komisioni për kontrollin e cilësisë së studimeve,
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave,
- Komisioni disiplinor,
- Komisioni për bashkëpunim dhe marrëdhënie me publikun, etj.

Njësitë e zhvillimit akademik kujdesen për zhvillimin e procesit mësimor; për hulumtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në punën studimore; për menaxhimin e njësisve të tjera mbështetëse të orientuar për të ndihmuar studimet.

2. Për punën hulumtuese dhe shkencore Kolegji BIZNESI krijon dhe vë në funksion:

I. Institutin për Hulumtime Shkencore,

Hulumtimet shkencore kanë për qëllim ndërmarrjen e aktiviteteve, me qëllim, sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm shkencor.

Institutin për Hulumtime Shkencore ka programin e vet të punës, në kuadër të të cilit funksionojnë këto njësi:

- a) Njësia për hulumtime ekonomike, juridike dhe emergjenca;

b) Njësia për trajnim dhe zhvillim të stafit akademik e të tjerëve.

Instituti për Hulumtime Shkencore përkrahë zhvillimin e stafit akademik, punën hulumtuese të profesorëve dhe studentëve të Kolegjit BIZNESI, përmes botimit të librave, të revistës shkencore, publikimeve të ndryshme, organizimit të konferencave shkencore, seminareve, simpoziumeve, tryezave të shkencore, workshopeve, kampeve verore të studimeve për studentët, si dhe organizon vizita studimore në institucione të ndryshme.

II. Instituti Statistikave,

Instituti Statistikave që nga viti 2011 është bashkuar me Kolegjin "BIZNESI" dhe si i tillë merret me hulumtime të opinionit dhe të fenomeneve ekonomike. Ky institut operon me kapacitete që burojnë kryesisht nga stafi akademik dhe nga studentët e Kolegjit "BIZNESI".

III. Instituti për zhvillimin e karrierës,

Instituti për zhvillimin e karrierës operon nga tetori i vitit 2011, ky institucion është i ndërtuar si pjesë e Kolegjit dhe ka për synim avancimin e njohurive në fusha të ngushta studimore dhe trajnime shtesë për stafin dhe studentët brenda dhe jashtë vendit.


IV. Shtëpinë Botuese të Kolegjit BIZNESI, që merret me botimin e librave, ligjëratave, dispensave dhe ushtrimeve të ndryshme. Është regjistruar në "Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës", dhe si e tillë ka numër dhe kod të vetin.

3. Në kuadër të njësisë mbështetëse ekziston Shërbimi i Administratës së përgjithshme, i cili është njësi përkrahëse për çështje akademike dhe studentore. Me këtë njësi përkrahëse udhëheq drejtoria e administratës. Shërbimi i administratës së përgjithshme ka këtë sektorë:

- Sektori për çështje administrative,
- Sektori për përkrahje logjistike, dhe
- Sektori për çështje financiare.

4. Në Kolegjin BIZNESI funksionon dhe Zyra për Vlerësimin e Cilësisë, e cila menaxhohet nga drejtoria e zyrës së stafit ndihmës, si dhe koordinatori i ECTS-ve.

Neni 14 Organogrami i Kolegjit BIZNESI



Neni 15 Programet mësimore

Në Kolegjin BIZNESI zhvillohen studime në programe në nivelin bachelor dhe në nivelin master.

Sipas vendimit për akreditim nga AKA, si dhe vendimit të MASHT për licencim, Kolegji BIZNESI veprimtarinë e tij akademike e zhvillon në katër programe studimore të nivelit bachelor, tre programe të nivelit master dhe një program niveli i III-të sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve:

a) Niveli Bachelor zhvillon programet:

- Banka dhe Financa në Biznes (grada: bachelor në Banka dhe Financa në Biznes);
- Menaxhimi i Emergjencave (grada: bachelor në Menaxhimin e Emergjencave);
- Juridik LLB (grada: bachelor në Juridik);
- Menaxhment dhe ekonomiks (grada: bachelor në Menaxhment dhe ekonomiks).

b) Niveli Master zhvillon programet:

- Menaxhimi i Emergjencave (grada: master në Menaxhimin e Emergjencave);
- Juridik - Penal (grada: master në Juridik - Penal); dhe
- Menaxhment dhe Financa (grada: master në Menaxhment dhe Financa).

c) Niveli i III-të sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: Teknik i Mbrojtjes nga Zjarri.

Neni 16

Riorganizimi, ndarja, bashkimi ose mbyllja e Kolegjit BIZNESI

1. Riorganizimi, ndarja, bashkimi me një institucion tjetër të arsimit të lartë ose mbyllja e Kolegjit BIZNESI bëhet me vendim të pronarit, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe udhëzimet administrative, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore mbi të cilat mbështetet ky statut.

2. Kolegji BIZNESI respekton standardet akademike të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, si dhe Agjencia e Akreditimit të Kosovës. Në përputhje me to, ai kryen vlerësimin e brendshëm të cilësisë së punës mësimore, shkencore dhe administrative dhe merr vendime për të ardhmen.

3. Kolegji BIZNESI financohet nga themeluesi i tij. Ai ka të drejtë të krijojë e të përdorë të ardhurat që realizohen nga veprimtaria e tij dhe donacione të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ta riorganizuar, ndarë, bashkuar me institucione të tjera të arsimit të lartë a mbyllur.

4. Kolegji BIZNESI ka për detyrë të raportojë çdo vit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për aktivitetin mësimor dhe shkencor.

KREU III

ORGANIET DREJTUESE TË KOLEGJIT BIZNESI

Neni 17

Organet dhe autoritetet drejtuese

1. Organi më i lartë drejtues i Kolegjit BIZNESI është Bordi. Organe të tjera akademike janë Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor dhe komisionet e përhershme.

2. Autoritetet drejtuese janë: Dekani, Sekretari i Përgjithshëm, përgjegjësit e degëve dhe njësisive, si dhe përgjegjësit e programeve mësimore.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor dhe autoritetet drejtuese akademike zgjidhen nëpërmjet një procesi të përgjithshëm zgjedhor, i cili zhvillohet një herë në çdo katër vjet.

Neni 18

Bordi

1. Bordi ka karakter këshillëdhënës për themeluesin e Kolegjit, është organ epror i Kolegjit, i zgjedhur, që mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e Kolegjit në aspektet administrative, financiare dhe ekonomike, politikat e zhvillimit, si dhe në ushtrimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë private të Kolegjit BIZNESI. Ai është organi më i lartë drejtues, ekzekutiv e urdhërdhënës i Kolegjit, në fushën administrative.

2. Bordi përbëhet nga (5) pesë anëtarë, prej të cilëve zgjidhet kryetari. Zgjedhja dhe shkarkimi nga detyra e anëtarëve të bordit bëhet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit.

3. Tre anëtarët e Bordit zgjidhen, si anëtar të jashtëm, që nuk janë të punësuar në Kolegj, një anëtarë po ashtu zgjidhet si anëtar i brendshëm dhe është i punësuar në Kolegj. Ndërsa themeluesi është anëtar i Bordit exofficio.

4. Kryetar i Bordit nuk mund të jetë themeluesi.

5. Mandati i anëtarëve të Bordit mbaron para kohe:

- a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerje vepr penale;
- b) kur anëtar i Bordit jep dorëheqjen;
- c) në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën;
- ç) kur anëtar i mungon pa arsye për tri seanca mbledhjesh, gjatë një viti akademik;
- d) kur shkarkohet nga kjo detyrë për shkelje të rënda të ligjit.

Në këtë rast bëhet zëvendësimi i anëtarit të larguar me anë të zgjedhjes nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencorbrenda katër javëve.

6. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit bëhet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor.

7. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të autoriteteve dhe të anëtarëve të zgjedhur të organeve, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur të organit drejtues është plotësues.

Neni 19

Funksionet e Bordit

1. Bordi mbledhet në seanca të zakonshme të paktën një herë në 2 muaj.

Rendi i ditës propozohet nga kryetari i Bordit ose themeluesi i Kolegjit dhe miratohet në çdo rast nga Bordi. Ai mund të mbledhet sipas nevojës edhe në seanca të jashtëzakonshme, me një rend të caktuar dite, me propozimin e themeluesit, kryetarit të Bordit, dekanit, përgjegjësitë e Programeve.

2. Mbledhja e Bordit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve; vendimet e tij merren, si rregull, me konsensus. Kur ky është i pamundur, vendimet merren me shumicën e thjeshtë votave. Vota e kryetarit të Bordit është e barabartë me votën e anëtarëve të tjerë.

3. Për marrjen e vendimeve, mirëkuptimi dhe votimi i hapur është procedurë e zakonshme. Çdo anëtar e ushtron vetë të drejtën e votës, pa pasur të drejtë ta delegojë dikë tjetër.

4. Mbledhjet e Bordit janë transparente dhe sipas kërkesave mund të jenë edhe të mbyllura. Vendimet e Bordit janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Kolegjit.

5. Bordi i Kolegjit BIZNESI ka këto funksione kryesore:

- a) Përcakton drejtimit investuese për zhvillimin e Kolegjit dhe miraton planet e shpenzimeve;
- b) I propozon themeluesit normat vjetore të ngarkesës financiare, mësimore, shkencore për personelin mësimor shkencor;
- c) I propozon KLMSH të gjitha llojet e kuotave të pranimeve të studentëve;
- d) Miraton Statutin dhe rregulloret e Kolegjit sipas kompetencës që ka;
- e) I propozon themeluesit politikën investimeve;
- f) I propozon themeluesit dhe KLMSH planet zhvillimore të Kolegjit, si dhe themelimin e njësisë (degëve) të reja akademike me vendim të bordit që veprojnë në kuadër të kolegjit.

Neni 20

Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor

1. Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor është organ akademik, dhe përbëhet nga 14 anëtarë:
 - Dekani,
 - Prodekani,
 - 4 përgjegjës të programeve,
 - 6 anëtarë të stafit akademik me marrëdhënie të rregullt pune nga programet,
 - 2 studentë që zgjedhën nga organizata studentore,
 - Sekretari i përgjithshëm (pa të drejtë vote).
2. Anëtarët e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit (shih pikën më sipër), zgjidhën nga programet, mbi bazën e një liste të renditur të përzgjedhur me sistem votimi nga personeli akademik apo studentor (sipas rastit). Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor ripërtërihet jo më rrallë se një herë në katër vjet me mundësi rizgjedhjeje.

Neni 21

Funksionet e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor

3. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor ka këto funksione:
 - a) garanton autonominë e Kolegjit, lirinë akademike dhe të drejtat e studentëve;
 - b) garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë;
 - c) garanton realizimin e objektivit për një Kolegj të bazuar në kërkimin shkencor, si dhe krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimoshkencore të personelit akademik;
 - ç) miraton paraprakisht planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit mësimor dhe të kërkimit shkencor dhe ia propozon për miratim përfundimtar Bordit;
 - d. Miraton planet mësimore sipas degëve,
 - dh. Harton kriteret e punësimit të personelit akademik,
 - e. Harton planin e zhvillimit strategjik të Kolegjit, si dhe merr iniciativë për themelimin e njësive (degëve) të reja që do të funksionojnë në kuadër të Kolegjit.
 - ë. Miraton strukturën e studimeve,
 - f. Miraton pranimin dhe avancimin e personelit akademik, dhe caktimin e udhëheqësve të programeve, degëve dhe njësive të Kolegjit.
 - g. I paraqet Bordit propozime për mbështetjen financiare për hapjen e degëve dhe njësive të reja,
 - gj. Miraton kriteret e pranimit të studentëve,
 - h. Miraton rregulloret e Kolegjit sipas kompetencës akademike që ka dhe formon komisione profesionale dhe shkencore,
 - i. Miraton raportet vjetore për aktivitetin mësimor dhe shkencor të Kolegjit dhe ia paraqet Bordit të Kolegjit,
 - j) Shqyrton çështjet e caktuara sipas kërkesës së parlamentit të studentëve,
 - j) Kryen detyra të tjera të parapara me këtë Statut.
 - k) pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit, miraton Statutin e Kolegjit;

- l) miraton programet e reja të studimit, si dhe ndryshimet dhe mbylljen e tyre;
- ll) miraton programet e reja të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre;
- m) propozon mbylljen dhe riorganizimin e Kolegjit, si dhe ndarjen, bashkimin me institucion/e të tjera të arsimit të lartë;
- n) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive e degëve të Kolegjit, pas vlerësimit paraprak të Bordit;
- nj) i paraqet kërkesë Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit, degëve apo vetë Kolegjit;
- o) i propozon Agjencisë së Kosovës për Akreditim hapjen, mbylljen, ndryshimin dhe emërtimin e njësive kryesore dhe të programeve të studimit;
- p) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së Kolegjit, të hartuar nga Dekanati, dhe ia përcjell atë Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
- q) shqyrton dhe vlerëson kërkesat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për hapjen e programeve të reja të arsimit në fusha parësore;
- r) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Kolegjit;
- rr) ngre komisione të përhershme të tij për të ndjekur drejtimet më të rëndësishme të veprimtarisë së institucionit dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre;
- s) Zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme, për një mandat dyvjeçar;
- sh) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
- t) miraton anëtarësimin e Kolegjit në organizata kombëtare e ndërkombëtare arsimore e shkencore, lidhjet e binjakëzimit me universitete e shkolla të tjera të larta të vendit e të huaja, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me organizma jofitimprurës, donatorë vendas e të huaj që mund të ndihmojnë në zhvillimin e Kolegjit, si dhe marrëveshjet që Dekani i përcjell për miratim;
- th) thërret Sekretarin e Përgjithshëm të Kolegjit për të raportuar për veprimtarinë e tij, të paktën dy herë në vit;
- u) merr vendime për çështje që janë të kompetencës së tij.

Neni 22

Mënyra e funksionimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor

1. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor e ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet vendimmarrjes kolegjiale, si edhe nëpërmjet komisioneve të krijuara prej tij.
2. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor kryesohet nga Dekani.
3. Në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Anëtari që e ka të pamundur pjesëmarrjen, duhet të njoftojë për arsyen e mungesës së tij, mundësisht 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes.
4. Mbledhjet e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor mbahen bazuar në planifikimin që ka bërë vetë Këshilli në mbledhjen e tij të mëparshme, me kërkesë të Dekanit ose të një të tretës së anëtarëve të tij. Asnjë çështje tjetër nuk mund të diskutohet jashtë atyre të përcaktuara në rendin e ditës, me përjashtim të rastit kur vetë Këshilli vendos ndryshe.
5. Mbledhjet e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Konsiderohen mbledhje të jashtëzakonshme ato që mbledhen jashtë radhe për çështje të ndjeshmërisë së lartë që prekin institucionin. Mbledhjet e zakonshme u njoftohen

anëtarëve të Këshillit, në postën e tyre elektronike zyrtare, të paktën 7 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. Mbledhjet e jashtëzakonshme u njoftohen anëtarëve të Këshillit, të paktën 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes publikohet në çdo rast edhe në faqen zyrtare të internetit të Kolegjit BIZNESI.

6. Mbledhjet e Këshillit, regjistrohen me mjete të teknologjisë së informacionit dhe për çdo mbledhje Këshillit mban procesverbal. Vendimet e tij publikohen brenda 24 orëve në faqen zyrtare të internetit të Kolegjit.

7. Mbledhjet e Këshillit janë të vlefshme nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, Dekani vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, e cila duhet të mbahet jo më parë se shtatë ditë.

8. Si rregull votimet në Këshillit janë të hapura. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë. Votim i fshehtë realizohet edhe kur e kërkojnë të paktën një e pesta e anëtarëve të Këshillit.

9. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës.

10. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër. Në rast se edhe në votimin e dytë ka përsëri barazi votash atëherë do të kryhet një votim i tretë. Në rast se edhe mbas votimit të tretë nuk arrihet asnjë shumicë votash, propozimi konsiderohet i rrezuar.

11. Anëtarët e Këshillit, që kanë votuar kundër kanë të drejtë të kërkojnë që në procesverbal të shënohet fakti dhe arsyet e këtij votimi.

12. Veçori të tjera të funksionimit të Këshillit përcaktohen në rregulloren e tij të funksionimit.

Neni 23

Themeluesi i Kolegjit BIZNESI

1. Vendimet që kanë të bëjnë me tarifat e shkollimit, pagat, investimet, të ardhurat dhe shpenzimet e Kolegjit, merren në çdo rast nga Bordi i Kolegjit.

2. Themeluesi është anëtar i Bordit (exofficio).

3. Themeluesi nuk ndërhyt në sferën akademike dhe nuk cenon lirinë akademike të pedagogëve.

4. Themeluesi nuk mund të jetë anëtar i KLMSH dhe as udhëheqës i asnjë njësie akademike në Kolegj.

Neni 24

Këshilli i Etikës Akademike

1. Këshilli i Etikës Akademike të Kolegjit shqyrton probleme të etikës së jetës në institucion; konkluzionet e tij, për çdo çështje që shqyrton, i përcillen dekanit, respektivisht prodekanit.

2. Anëtarët e Këshillit të Etikës Akademike zgjedhen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor (KLMSH).

3. Përbërja dhe detyrat, si dhe mënyra e punës e këtij këshilli, përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga KLMSH-ja dhe të firmosur nga dekan.

Neni 25 **Dekani**

1. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Dekani zgjidhet me konkurs nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit, me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhjeje. Dekani duhet të ketë titullin jo më të ulët se “profesor asistent”.
3. Kandidatët për dekan duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 5 vjet;
 - b) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 3 vitesh;
 - c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - ç) të mos jenë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale.
4. Dekani zgjidhet me shumicën absolute (shumicën e anëtarëve të përgjithshëm) në pajtim me dispozitat e këtij Statuti. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Nëse asnjëri nga dy kandidatët nuk fiton shumicën absolute tri herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, siç është paraparë në këtë Statut.
5. Mandati i rektorit fillon me një tetor.
6. Bordi i Kolegjit në konsultim me Këshilline Lartë Mësimor Shkencor nxjerr rregulloren për procedurën e zgjedhjes dhe mandatin e Dekanit.

Neni 26 **Funksionet e Dekanit**

1. Dekani kryen funksionet si më poshtë:
 - a) Drejton Këshilline Lartë Mësimor Shkencor;
 - b) I propozon për zgjedhje KLMSH-së kandidaturat për përgjegjësit e Kolegjit, si sekretarin e Përgjithshëm, përgjegjësit e programeve, personelin akademik dhe përgjegjësit e degëve e njësive, si dhe kryen emërimet pas miratimit të tyre nga KLMSH.
 - c) Firmos dhe Vërteton diplomat e përfundimit të studimeve, pasqyrën e notave, certifikatën e përfundimit të studimeve, pa pasur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë;
 - ç) Propozon personelin mësimor-shkencor i cili për vitin akademik, do të ketë ngarkesë më të ulët nga norma mësimore duke e përcaktuar këtë ngarkesë;
 - d) Miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - e) Formon komisione dhe grupe pune ad-hoc për çështje, studime e veprimtari të veçanta;
 - f) I paraqet Bordit për miratim planin e shpenzimeve financiare, të propozuar nga KLMSH, në fillim të vitit akademik;
 - g) Organizon punën për vlerësimin e brendshëm të Kolegjit.

gj) Nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe administrativ në Kolegjin BIZNESI.

h) I paraqet Bordit planin strategjik të zhvillimit të institucionit;

i) Nënshkruan titujt akademikë “Profesor asistent” dhe “Profesor” pas miratimit të tyre;

j) Trajton ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të Kolegjit dhe u propozon strukturave përkatëse marrjen e vendimeve në lidhje me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) Ushtron kontrolle, për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, zbatimit të kontratave të punës dhe për çdo veprimtari tjetër që kryejnë strukturat e Kolegjit;

l) Autorizon, në rast nevoje, hyrjen e forcave të rendit në mjediset e Kolegjit;

ll) Nënshkruan marrëveshjet me karakter akademik apo protokollet e bashkëpunimit të Kolegjit me të tretët, si edhe anëtarësimin në shoqatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Për marrëveshjet për të cilat kërkohet miratimi i Bordit, Dekani i nënshkruan ato mbas miratimit paraprak të tij.

m) Mbikëqyr zbatimin e vendimeve, masave dhe kërkesave të Bordit e KLMSH.

2. Menaxhimin e degëve Gjakovë, Vushtrri dhe Prizren, Dekani e realizon nëpërmjet delegimit të autoritetit të Përgjegjësit të degëve, të cilët përgjithësisht ushtrojnë këto detyra:

a) Organizojnë procesin mësimor në degën përkatëse të Kolegjit BIZNESI;

b) Monitorojnë procesin e punës në njësitë përkatëse;

c) Përgjigjen për punët organizative;

d) Raportojnë në Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor dhe te Dekani, për mirëvajtjen e procesit të edukimit për njësitë përkatëse.

3. Dekani, në ushtrim të funksioneve të tij, shprehet me vendime, urdhra dhe udhëzime.

4. Dekani largohet nga detyra:

- me përfundim të mandatit

- kur jep dorëheqjen,

- kur ka shkelje të akteve ligjore e nënligjore, si dhe të Statutit dhe të Rregullores së Kolegjit me shkarkim nga KLMSH-ja.

- i padenjë për të ushtruar detyrën e dekanit.

- me vdekjen e tij.

5. Në rast dorëheqjeje të dekanit ose pamundësisë për të ushtruar detyrën e vet, deri në zgjedhjen e dekanit të ri, KLMSH autorizon prodekanin ta kryej punën e dekanit.

Neni 27

Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit BIZNESI

1. Për mbarëvajtjen administrative dhe ekonomike të Kolegjit, Sekretari i përgjithshëm zgjidhet me konkurs publik.

2. Sekretari i përgjithshëm duhet të jetë specialist me përgatitje të lartë juridike ose ekonomike dhe me përvojë organizuese.

3. Sekretari i përgjithshëm përfaqëson në kontestet ligjore Kolegjin.

4. Sekretari i përgjithshëm mbikëqyrë punën e administratës, dosjeve akademike të studenteve dhe stafit akademik, administrativ dhe rregullsinë e tyre, si dhe lëshon dëshmi lidhur me çështjet administrative studentore dhe akademike.

5. Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për nxjerrjen e akteve ligjore e atyre nënligjore.
6. Sekretari i përgjithshëm raporton në Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor.
7. Sekretari i përgjithshëm ka edhe këto detyra dhe kompetenca:
 - a) Përcjell gjithë veprimtarinë ekonomike e administrative të Kolegjit;
 - b) Organizon dhe përcjell hartimin e zbatimin e planit të buxhetit dhe i paraqet Bordit projektin për ndarjen e fondeve buxhetore, si dhe të burimeve të tjera të financimit;
 - c) Organizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të Kolegjit;
 - ç) Harton projektet për strukturën organizative dhe analitike të gjitha njësive administrative vartëse të Kolegjit, si dhe projektet për drejtimin administrativ të tij;
 - d) Organizon kryerjen e kontrollit dhe revizionit financiar;
 - e) Organizon veprimtaritë e shërbimeve ndaj palës së tretë në Kolegji;
 - f) Është kryetar i komisioneve të investimeve, të blerjeve, të mjeteve materiale;
 - g) Përfaqëson Kolegjin si firmë e parë e deleguar nga themeluesi në marrëdhëniet financiare me bankat dhe në të gjitha marrëdhëniet kontraktore me palën e tretë, brenda fushave të veprimtarisë që ai mbulon;
 - gj) Përgjigjet për shlyerjen e detyrimeve të Kolegjit ndaj organeve shtetërore, për pagimin e taksave, tatimeve, si dhe detyrimeve ndaj palës së tretë;
 - h) Përgjigjet për respektimin e procedurave të regjistrimeve të studentëve.

Neni 28

Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale të krijuara në nivel institucional dhe në nivel të njësive kryesore, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit. Komisionet e përhershme e ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe marrin vendime sipas kompetencave të parashikuara në ligjin nr. 04/L-037 *“Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”* dhe në këtë Statut, ose i propozojnë mbledhjes së Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të këtij të fundit.
2. Numri i komisioneve të përhershme, si dhe numri i anëtarëve përcaktohet në statut. Zëvendësimi i anëtarëve të komisioneve bëhet sipas renditjes së listës të kandidatëve.
3. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor ngre komisionet e përhershme në nivel institucional si më poshtë:
 - a) Komisionin e promovimit të personelit akademik;
 - b) Komisionin e sigurimit të standardeve të cilësisë;
 - c) Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të marrëdhënieve me studentët;
 - ç) Komisionin e kurrikulave;
4. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve përcaktohet nga rregullorja e brendshme e Kolegjit Biznesi.
5. Një anëtar i personelit akademik me kohë të plotë apo student, mund të jetë anëtar vetëm në një komision të përhershëm.
6. Kryetarët e komisioneve zgjidhen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.

7. Anëtarët e komisioneve zgjidhen për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
8. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.
9. Rregulla të tjera për funksionimin e komisioneve të përhershme parashikohen në Rregulloren e brendshme të Kolegjit BIZNESI dhe rregulloren e funksionimit të tyre.

Neni 29

Komisioni për promovimin e personelit akademik

1. Komisioni për promovimin e personelit akademik, është struktura përgjegjëse për dhënien e titujve “Profesor asistent” dhe “Profesor” në Kolegjin BIZNESI, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Ata përzgjidhen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Në përbërje të Komisionit, duhet të ketë të paktën një anëtar nga secili program.
4. Anëtarët e Komisionit duhet të plotësojnë këto kritere:
 - a) të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b) të mbajnë titullin “Profesor i Asistent” dhe të kenë së paku dy vite përvojë në mësimdhënie, pas fitimit të këtij titulli;
 - c) të kenë përvojë pune si anëtar të personelit akademik të paktën 3 vjet;
 - ç) të mos jenë anëtarë të zgjedhur në organet drejtuese.
5. Komisioni vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, me votim të fshehtë.
6. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohet në rregulloren e tij.
7. Gjatë veprimtarisë së tij, Komisioni zbaton kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për vlerësimin e kandidatëve dhe dhënien e titujve akademikë.

Neni 30

Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë

1. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit.
2. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë përbëhet nga 7 anëtarë. Në përbërje të KPSSC-së zgjidhet të paktën nga një përfaqësues nga secili program, një përfaqësues nga strukturat e sigurimit të cilësisë, një përfaqësues nga institutet/degët, një përfaqësues nga studentët. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e Komisionit, pjesë e personelit akademik, duhet të plotësojnë këto kritere:
 - a) t'i përkasin kategorisë “Profesor i Asistent”;
 - b) të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku dy vjet;
 - c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi.Anëtari i Komisionit, përfaqësues i studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 9-të.
3. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.

4. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohen në këtë Statut dhe në rregulloren e tij.

Neni 31

Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët

1. Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët ngrihet për të garantuar dhe për të zhvilluar marrëdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të Kolegjit dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 4 janë anëtarë pjesë e personelit akademik dhe 1 anëtarë përfaqësues i studentëve. Anëtarët përfaqësues të studentëve dhe anëtarët përfaqësues të personelit akademik zgjidhen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Komisioni ushtron këto funksione:

- a) harton politikat për trajtimin e studentëve;
- b) bashkëpunon me Këshillat Studentorë dhe koordinon punën me ta;
- c) propozon mbështetjen financiare dhe logjistike të projekteve të studentëve;
- ç) kërkon informacione të ndryshme nga njësitë kryesore për probleme të studentëve;
- d) kërkon informacion nga organet përbërëse të institucionit për çështje dhe probleme të paraqitura nga studentët dhe organizmat e tyre.

3. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.

4. Organizimi dhe funksionimi i këtij komisioni përcaktohen në rregulloren e tij.

Neni 32

Komisioni i përhershëm i kurrikulës

1. Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës është struktura përgjegjëse për vlerësimin e projekt-programeve të paraqitura sipas parashikimeve të këtij Statuti.

2. Ky Komision përbëhet nga 7 anëtarë. Në përbërje të tij zgjidhet të paktën një përfaqësues nga secili program, përfaqësues nga strukturat administrative, përfaqësues nga institutet, si edhe një përfaqësues nga studentët. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e Komisionit, pjesë e personelit akademik, duhet të plotësojnë këto kritere:

- a) t'i përkasin kategorisë “Profesorass”;
- b) të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare;
- c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

Anëtari i Komisionit, përfaqësues i studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 9-të.

3. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.

4. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohen në rregulloren e tij.

Neni 33

Këshilli i etikës

1. Këshilli i etikës është organ kolegjal i Kolegjit BIZNESI.

2. Këshilli i etikës promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të etikës dhe legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Kosovës.

3. Këshilli i etikës merr vendime me shumicë votash dhe i paraqet rekomandimet e tij Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor.

4. Këshilli i etikës përbëhet nga 7 anëtarë.

5. Nga çdo program i propozohet Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor një kandidat, pjesë e personelit akademik me kohë të plotë.

6. Anëtari i shtatë zgjidhet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor midis anëtarëve të tij.

7. Dy anëtarë, nga radhët e studentëve, me mesatare mbi 9-të, zgjidhen nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor.

8. Në procesin e emërimit të anëtarëve, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor duhet të kujdeset, që së paku tre anëtarë të jenë të njërës prej gjinive.

9. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor përzgjedh nga radhët e anëtarëve të Këshillit të etikës kryetarin dhe sekretarin e tij.

10. Mandati i anëtarëve të Këshillit të etikës është 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

11. Këshilli i etikës i propozon për miratim Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, Kodin e Etikës të Kolegjit. Projekt-kodi i përgatitur nga Këshilli i etikës, përpara se të dërgohet për miratim, duhet të kalojë për konsultim në të gjitha njësitë kryesore e bazë të Kolegjit BIZNESI.

12. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e tij, e cila hartohet nga Këshilli i etikës dhe miratohet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor.

KREU IV ORGANET DREJTUESE NË PROGRAME

Neni 34

1. Organet drejtuese të Programit janë:

- Përgjegjësi i Programit.
- Këshilli i Programit.

Neni 35

Përgjegjësi i programit

1. Përgjegjësi është drejtues i një Programi, i cili zgjidhet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhjeje.

2. Përgjegjësi duhet të ketë gradë ose titull shkencor (Doktor i shkencave).

3. Përgjegjësi i Programit ka këto kompetenca:

- a) Drejton të gjithë punën mësimore e shkencore në Programit;
- b) Miraton rregulloret e brendshme të njërive në përbërje të Programit;

c) I propozon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor anëtarët dhe kryetarët e komisioneve të provimeve të pranimit, të provimit të formimit profesional e mbrojtjes së diplomave, miraton pyetjet e provimeve të pranimit, të provimit të formimit profesional dhe temat e diplomave;

ç) I propozon dekanit përjashtimin nga Kolegji të studentëve për rastet e parashikuara në Rregulloren e Programit;

d) I paraqet dekanit çdo vit raportin për aktivitetin mësimor, shkencor dhe financiar të Programit;

e) Organizon vlerësimin e brendshëm në Programit;

f) Përzgjedh (nga kandidaturat e paraqitura) dhe i propozon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor personelin akademik.

g) Emëron personelin ndihmës, udhëheqësit e njësive të tjera të Programit, sektorëve të departamentit, nga kandidaturat e përzgjedhura, paraprakisht nga organet kompetente të Programit.

4. Kur me veprimet e tij përgjegjësi i Programit shkel, në mënyrë të përsëritur Statutin, aktet ligjore, aktet nënligjore e rregulloret e Kolegjit, dekani i kërkon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, shkarkimin e tij dhe zgjedhjen e një përgjegjësi të ri. Funkzioni i përgjegjësit të Programit pushon edhe kur jep dorëheqje, kur i përfundon mandati, për arsye shëndetësore dhe në rast vdekjeje.

5. Përgjegjësi i Programit emëron zëvendës përgjegjësin e Programit, i cili në mungesë të përgjegjësit dhe me autorizimin e tij, ushtron të gjitha përgjegjësit në Program.

Neni 36 **Këshilli i Programit**

1. Këshilli i Programit është organ akademik. Ai përbëhet nga përgjegjësi i Programit, nga personeli akademik i rregullt i Programit dhe nga 2 përfaqësues të studentëve.

2. Anëtarët e Këshillit të Programit janë të gjithë mësimdhënësit e rregullt dhe dy përfaqësues të studenteve që zgjidhën nga Organizata studentore. Ky organ ripërtërihet në rastet e punësimit të mësimdhënësve të rinj në fillim të vitit akademik.

3. Këshilli i Programeve ka këto funksione:

a. i propozon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor planet mësimore sipas degëve dhe kriteret themelore të ekuivalentimeve të formimeve paraprake të studentëve,

b. harton kriteret e përzgjedhjes të personelit akademik dhe i propozon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor,

c. harton planin e zhvillimit strategjik të Programit dhe ia propozon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor për miratim,

d. i propozon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor miratimin e strukturës të studimeve,

e. i paraqet Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor propozime për hapjen e degëve të reja,

f. harton dhe ia propozon Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor kriteret e pranimit të studentëve,

g. harton Rregulloret e Programit,

gj. harton raportimet vjetore për aktivitetin mësimor dhe shkencor të Programit dhe ia paraqet Dekanit,

4. Me kërkesë të përgjegjësit të Programit, shqyrton çështje që kanë të bëjnë me Programin.

KREU V PERSONELI I KOLEGJIT BIZNESI

Neni 37 Personeli i Kolegjit

1. Personeli i Kolegjit BIZNESI përbëhet nga:
 - a) Punonjësit mësimorë shkencorë (akademikë) të brendshëm e të jashtëm;
 - b) Personeli ndihmës mësimor shkencor;
 - c) Personeli administrativ;
 - ç) Personeli bibliotekar;
 - d) Personeli i shërbimit të përgjithshëm;
2. Pranimi në vendetë punës për këtë personel bëhet me përzgjedhje, sipas sistemit të konkursit publikpëryjashtimisht të shpalljes interne.
3. Kontratat e punës, për personelin mësimor shkencor dhe atë ndihmës të Kolegjit, nënshkruhen nga Dekani, ndërsa për personelin tjetër nga Dekani ose Sekretari i Përgjithshëm.
4. Kushtet e kontratës së punës, koha për të cilën lidhet ajo dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me marrëdhëniet epunës, përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.
5. Aktivizimi i punonjësit mësimor shkencor të jashtëm bëhet me kontratë me një afat të caktuar, sipas lëndës; kontrata nënshkruhet nga dekani, i cili autorizohet t'i nënshkruajë kontratat në përputhje me ligjin; ajo nënshkruhet çdo vit ose sipas marrëveshjes për një periudhë kohore minimale për tri vitet akademike dhe përcakton kushtet e punës, detyrimet reciproke dhe pagën.
6. Punonjësit mësimor të cilët janë zgjedhur për lëndët e caktuara ose kanë fituar thirrje akademike në ndonjë universitet tjetër do t'u pranohen dhe mund të angazhohen për mësimdhënie në Kolegj nëse vlerësohet nga Komisioni Vlerësues – Recensues i Kolegjit BIZNESI.
- 7 Në rast se kontrata nuk ka ndryshime nga një vit më parë, quhet e vlefshme.
8. Personeli akademik zgjedhet me konkurs (publik apo intern).
9. Personeli akademik dhe administrativ gëzon të gjitha të drejtat dhe ka detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të parashikuara në këtë Statut dhe në kontratën e lidhur ndërmjet tij dhe Kolegjit.
10. Kolegji krijon, për të gjithë personelin e vet, kushte, mundësi dhe shanse të barabarta për zhvillimin e personalitetit, karrierës profesionale, si dhe të kushteve të punës.

Neni 38 Statusi i personelit akademik dhe administrativ

1. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë, në përputhje me ligjin nr. 04/L-037 *“Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”*.

2Aspekte të trajtimit financiar, si dhe përfitime të tjera për personelin, përcaktohen nga Bordi, me propozim të Dekanit.

Neni 39

Kategoritë e personelit akademik

1. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të Kolegjit, këshillim për studentët, si dhe veprimtari të tjera.

2. Personeli akademik mund të jetë me drejtim mësimor dhe kërkimor-shkencor. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: a) profesor; b) ligjërues; c) asistent-ligjërues; d) asistent.

3. Në kategorinë “Profesor” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor Asistent” ose “Profesor”.

4. Në kategorinë “Ligjërues” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, si dhe kanë së paku tri vite përvojë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade shkencore.

5. Në kategorinë “Asistent-Ligjërues” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Ata duhet të kenë diplomën “Master i shkencave”.

6. Në kategorinë “Asistent” përfshihen anëtarët e personelit akademik që janë ndihmës të bartësit të lëndës. Ata duhet të kenë diplomën “Master i shkencave”.

Neni 40

Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë

1. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur përmes një procesi transparent, të paanshëm dhe objektiv.

2. Përcaktime mbi mënyrën e hartimit të kriterëve dhe mënyrën e shpalljes së vendeve të punës përcaktohen në rregulloren e brendshme të Kolegjit.

3. Për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Krijohet komision adhocprejtre anëtarësh, që nuk duhen të kenë konflikt interesi dhe që i përkasin kategorisë “Profesor Asistent” a “Profesor”.

4. Kryesues i komisionit caktohet anëtari që miratohet nga radhët e Programit përkatës, i cili është me titullin akademik më të lartë dhe me përvojën më të vjetër akademike.

5. Komisioni, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Komisioni, brenda tri ditëve pune nga dita e zhvillimit të intervistës, shpall kandidatin/kandidatët fitues. Konkurrimi zhvillohet në mjediset e njësisë kryesore ku edhe shpallen kandidatët fitues, shoqëruar dhe me publikimin në faqen zyrtare të njësisë Kolegjit.

6. Komisioni adhoc i paraqet kandidatin/kandidatët fitues Dekanit të Kolegjit. Dekani, brenda 10 ditëve nga shpallja e kandidatit/kandidatëve fitues, nënshkruan kontratën e punës me të/ta dhe nga ky moment fillojnë marrëdhëniet e punës.

Neni 41

Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme

1. Njësitë kryesore, me propozim të njësisive bazë, të cilat përcaktojnë nevojat e tyre për personel akademik joefektiv, i kërkojnë Dekanit miratimin e personelit akademik me kontratë të përkohshme. Ky propozim mund të realizohet vetëm nëse ngarkesa mësimore nuk plotësohet me personelin akademik me kohë të plotë. Dekani, duke u mbështetur në propozimet e njësisive kryesore dhe në varësi të fondit të miratuar për këtë qëllim, miraton çdo vit listën emërore të personelit akademik me kontratë të përkohshme.

2. Kjo kontratë do të nënshkruhet nga Dekani për një punë të caktuar ose për një periudhë kohe të caktuar.

3. Rregulla më të hollësishme për mënyrën e konkurrimit për personelin akademik me kontratë dhe kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët, përcaktohen në rregulloren e brendshme të Kolegjit.

4. Njoftimi për nevojën për personel akademik bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Kolegjit dhe mjeteve të tjera publike të informimit.

Neni 42

Kohëzgjatja e punës së personelit akademik

1. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, ndërsa personeli akademik që mban titullin “Profesor i asociuar” shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Personeli akademik i kategorisë lektor qëndron në detyrë deri në moshën e pensionit, në përputhje me legjislacionin përkatës. Me kërkesë të argumentuar nga njësia bazë, personeli akademik qëndron në detyrë në punë deri në fund të vitit akademik.

2. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e anëtarit të personelit akademik të kategorisë “Profesor”, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme. Në këto raste, për të realizuar këtë marrëdhënie të re pune, personeli akademik i kategorisë “Profesor” i drejtohet Kolegjit, me një kërkesë, ku parashtron vullnetin e tij për të vazhduar kontributin e tij. Kërkesa miratohet nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor.

3. Zgjatja e marrëdhënies së punës, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të bëhet vetëm nëse realizohet njëri prej këtyre kushteve:

a) Largimi i anëtarit të personelit akademik bën që të zbresë numri minimal i anëtarëve me tituj akademikë që kërkohen për funksionimin e departamentit, sipas kërkesave ligjore;

b) Nuk ka anëtarë të tjerë të kategorisë “Profesor” në lëndën që anëtari i personelit akademik jep mësim apo në fushën e kërkimit-shkencor ku pedagogu ushtron aktivitetin;

c) Kur vlerësohet kontributi i posaçëm i personelit akademik në fushën përkatëse.

Neni 43

Norma mësimore dhe koha e punës e pushimit

1. Mësimdhënia është detyrim, me së paku 8 orë mësim në javë në auditor për të gjithë personelin akademik, llogaritur kjo si mesatare vjetore. Ngarkesa e plotë për personelin akademik përcaktohet me udhëzim të ministrit të Arsimit, Shkencës e Teknologjisë së Republikës së Kosovës. Kjo normë, për çdo kategori punonjësi mësimor, rastet e lejimit të uljes së saj, elementët përbërës të saj si dhe konvertimi i elementeve përkatës, përcaktohen me vendime të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor.

2. Personelit akademik i njihet e drejta e pagesës së plotë të orëve të realizuara mbi normën mësimore dhe e veprimtarive të tjera që lidhen me të, pasi të jetë justifikuar plotësimi i gjithë detyrimeve kërkimore dhe akademike të planifikuara në planin vjetor.

3. Në Kolegjin “Biznesi” koha javore e punës është jo me pak se 40 orë; koha ditore normale e punës është 8 orë.

4. Pushimi vjetor për punonjësit mësimor shkencor është i rregulluar sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës.

5. Personeli akademik gëzon të drejtën e kualifikimit shkencor, i cili mund të kryhet brenda Kolegji ose jashtë tij. Kolegji krijon kushte lehtësuese për kualifikimin shkencor të personelit të tij akademik.

6. Problemet e tjera lidhur me kohën e punës, ngarkesën dhe pushimin përcaktohen në kontratën e punës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 44

Kontratat e punës për personelin akademik e administrativ

1. Kontratat e punës, për të gjithë personelin akademik të Kolegjit, nënshkruhen nga Dekani, në përfundim të procedurave të punësimit të përcaktuara në ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës” dhe në këtë Statut. Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos:

- identitetin e palëve;
- vendin e punës;
- përshkrimin e punës që do të kryejë individi;
- datën e fillimit;
- kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës;
- kohëzgjatjen e kohës së punës dhe të pushimit;
- pagën.

Neni 45

Përgjegjësia disiplinore

1. Personeli akademik është përgjegjës për shkeljet e disiplinës në punë dhe të mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara në legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në këtë Statut dhe rregulloret apo aktet e tjera të Kolegjit BIZNESI. Shkeljet disiplinore kategorizohen, si më poshtë, në:

- a) shkelje të rënda;
- b) shkelje të lehta.

2. Konsiderohen shkelje të rënda:

- a) shkelja ose moszbatimi i hapur i dispozitave ligjore dhe nënligjore;
 - b) mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, kur këto afate janë të arsyeshme dhe në raport me ngarkesën e punës së personelit;
 - c) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, i favoreve, i premtimeve ose i trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës;
 - ç) shkelja e të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale.
 - d) shkelja e përsëritur e rregullave të etikës;
3. Konsiderohen shkelje të lehta:
- shkelja e etikës, neglizhenca e qartë dhe e vazhdueshme në procesin e organizimit të provimeve, sa i takon orarit, shpërndarjes së studentëve dhe kohës së nxjerrjes së rezultateve.
4. Raste të tjera të cilat përbëjnë shkelje të lehtë apo të rëndë, përcaktohen në rregulloren e brendshme të Kolegjit, në përputhje me kriteret e mësipërme.

Neni 46

Procedimi disiplinor

1. Për shkeljet e lehta, Komisioni disiplinor ka të drejtë që të japë masën disiplinore “Vërejtje”.
2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit disiplinor përcaktohen në rregulloren e brendshme të Kolegjit.
3. Në rastin kur shkeljet disiplinore verifikohen se janë të rënda, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor, ngre një komision disiplinor adhoc, i cili përbëhet nga tre anëtarë të përzgjedhur midis anëtarëve të Këshillit. Ky komision ka të drejtë që të marrë këto masa disiplinore:
 - a) vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;
 - b) pezullim nga detyra deri në 3 muaj;
 - c) në rastet kur shkelja është e rëndë dhe e përsëritur, Komisioni mund t’i kërkojë Dekanit zgjidhjen e kontratës me anëtarin e personelit akademik dhe largimin e tij nga detyra.
4. Në rast kërkesë nga Komisioni disiplinor adhoc, Dekani bën zgjidhjen e kontratës duke respektuar kërkesat e Kodit të Punës.
5. Masa “Vërejtje” jepet për shkelje të lehta dhe regjistrohet në dosjen e personelit efektiv. Kjo masë konsiderohet si e padhënë dhe hiqet nga dosja e personelit me kalimin e një afati 6muajor, kur gjatë të cilit personi nuk merr një masë tjetër të njëjtë ose më të rëndë disiplinore.

Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” jepet për shkelje të rënda, si dhe në rast se brenda një afati 6-mujor personeli ka marrë dy masa “Vërejtje”. Kjo masë disiplinore regjistrohet në dosjen e personelit dhe i ruan efektet për një periudhë 1-vjeçare.

“Zgjidhja e kontratës së punës dhe largimi nga detyra i personelit akademik” kryhet për veprime në kundërshtim flagrant dhe të hapur me etikën dhe rregullat e funksionimit të institucionit, ose kur brenda periudhës një vjeçare personeli është në kushtet e marrjes së një mase të dytë “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”.
6. Komisioni disiplinor adhoc, ka të drejtën dhe detyrimin që të kryej një hetim të plotë administrativ duke vënë në dispozicion të personit që hetohet të gjitha materialet e procedimit, si dhe duke i dhënë atij të drejtën për t’u mbrojtur përmes mundësisë për t’u shprehur me shkrim, si edhe për të zhvilluar seancë dëgjimore me të.

Neni 47

Mbarimi i marrëdhënies së punës

Mbarimi i marrëdhënies së punës bëhet kur personeli akademik:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) mbaron afati i parashikuar në kontratën e punës;
- ç) bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike dhe mendore;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës me burgim;
- dh) merret masa disiplinore e largimit nga puna;
- e) raste të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 48

Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik e administrativ

1. Të drejtat dhe detyrimet e personelit përcaktohen në kontratat vetjake të punës, në Kodin e Punës, në Statut dhe në akte të brendshme të Kolegjit BIZNESI.

2. Të drejtat e personelit akademik janë si vijon:

a) Pedagogu ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha mundësitë logjistike që ofron Kolegji, duke respektuar të gjitha rregullat e brendshme të institucionit;

b) Të kërkojë nga njësia bazë respektimin dhe zbatimin e të gjitha detyrimeve të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe atij kërkimor;

c) Të kërkojë nga organet drejtuese të njësisë kryesore dhe të Kolegjit respektimin e të drejtave të tij që burojnë nga Kodi i Punës dhe nga ligji nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”;

d) Të zbatojë vetë dhe të kërkojë nga të tjerët një frymë etiko-morale në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me Kodin e etikës;

e) Të kërkojë respektimin e lirisë akademike.

ë) Të kualifikohet, specializohet jashtë shtetit në një sektor të fushës së tij, për një periudhë kohe deri në një vit. Kjo kohë mund të konsumohet si e tërë ose me pjesë. Për këto raste, merret vendim nga KLMSH, me propozim të Dekanit. Në këtë rast nënshkruhet kontratë e posaçme.

f) Të kryejnë studime pasuniversitare, kurse kualifikimi e specializimi në përputhje me planet e kualifikimit të miratuara në KLMSH, në interes të zhvillimeve shkencore e akademike të Kolegjit. Këto raste përjashtohen nga kufizimi kohor i pikës (ë) të këtij neni. Në këtë rast nënshkruhet kontratë e posaçme.

3. Detyrimet e personelit akademik janë si vijon:

a) Të respektojë statutin, rregulloret, si dhe Kodin e etikës së institucionit;

b) Të hartojë programin mësimor të lëndës, ta plotësojë dhe ta përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme dhe ta dorëzojë atë në zyrën përkatëse;

c) Të kryejë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar nga Kolegji, duke garantuar nivele të larta mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor;

d) Të përballojë ngarkesën mësimore të përcaktuar nga Kolegji;

- e) Të ndjekë sistematikisht zhvillimin dhe arritjet e shkencës përkatëse në plan kombëtar dhe botëror dhe ta pasqyrojë atë në procesin mësimor;
 - f) Të hartojë në kohën e duhur pyetjet e provimit duke i riformuluar dhe përditësuar ato çdo vit;
 - g) Të plotësojë me përgjegjësi regjistrin e pedagogut;
 - h) Të përcaktojë oraret e konsultimeve me studentët dhe t'i zhvillojë ato në përputhje me orientimet e Kolegjit;
 - i) Të respektojë oraret e zhvillimit të procesit të rregullt mësimor;
 - j) Të ruajë bazën materiale që ka në ngarkim e në përdorim;
 - k) Të zbatojë urdhrat e autoriteteve, organeve drejtuese, të lidhura me zhvillimin e procesit mësimor dhe zhvillimin e provimeve;
 - l) Të bashkëpunojë në aktivitetet shkencore të organizuara nga Kolegji;
 - m) Të zbatojë çdo urdhër të posaçëm të autoritetit drejtues përkatës, për situata të veçanta, emergjente, apo ngjarje të rëndësishme në institucion.
4. Të drejta dhe detyrime të tjera të personelit akademik përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

KREU VI

FAQJA E INTERNETIT DHE POSTA ELEKTRONIKE

Neni 49

Faqja zyrtare e internetit

1. Kolegji BIZNESI dhe njësitë e degët kryesore të tij ndërtojnë dhe mirëmbajnë faqen zyrtare të internetit.
2. Në faqen zyrtare të internetit të Kolegjit BIZNESI duhet të gjejnë pasqyrim:
 - a) Të dhëna për anëtarët e organeve kolegjiiale drejtuese dhe drejtuesit e Kolegjit BIZNESI, si edhe jetëshkrimet e tyre;
 - b) Të dhëna për drejtuesit e aparatit të Kolegjit dhe jetëshkrimet e tyre;
 - c) Ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Kosovës;
 - ç) Kopje elektronike të statutit, të rregullores së brendshme të Kolegjit, si edhe të rregulloreve të organeve të tjera kolegjiiale drejtuese të Kolegjit dhe çdo rregullore tjetër që përdoret nga aparati administrativ i Dekanatit të Kolegjit BIZNESI;
 - d) Kopje të çdo marrëveshjeje të lidhur nga Kolegji BIZNESI, njësitë a degët e tij;
 - dh) Çdo vendimmarrje dhe aktivitet që realizohet nga Kolegji BIZNESI;
 - e) Çdo e dhënë, informacion apo akt tjetër që kërkohet nga aktet e Kolegjit BIZNESI, si edhe çdo e dhënë tjetër që çmohet e nevojshme.
3. Për njësitë kryesore dhe degët e Kolegjit BIZNESI duhet të gjejnë pasqyrim:
 - a) Të dhënat për drejtuesit e njësive kryesore e degëve dhe jetëshkrimet e tyre;
 - b) Të dhënat për personelin akademik të njësive degëve dhe jetëshkrimet e tyre;
 - c) Çdo e dhënë tjetër, informacion, vendim, data provimesh etj. që kërkohet nga aktet e Kolegjit BIZNESI, si edhe çdo e dhënë tjetër që çmohet e nevojshme;

ç) Të dhëna për veprimtarinë mësimore: strukturën akademike, orarin mësimor, sesionet e provimeve etj.;

d) Të dhëna për planet mësimore të degëve bachelor emaster, për programet lëndore të secilit plan, botimet mësimore (tekste), kjo në shqipe dhe në gjuhën angleze;

dh) Të dhëna për veprimtarinë kërkimore: buletine; botimet shkencore (publikime, kumtesa, monografi, raporte etj.);

e) Të dhëna për projektet me karakter mësimor-shkencor, produktet e tyre;

ë) Të dhëna për laboratorët kryesorë dhe mundësitë e analizave që ofrojnë etj.

Neni 50

Posta elektronike

1. Me qëllim sigurimin e komunikimit zyrtar, midis organeve drejtuese të çdo niveli, midis personelit akademik dhe administrativ me studentët, Kolegji BIZNESI krijon dhe mirëmban postën elektronike.

2. Në zbatim të kësaj dispozite, secili anëtar i personelit akademik dhe administrativ, si dhe çdo student pajiset me një adresë të tillë.

3. Posta elektronike përdoret si mjet i komunikimit zyrtar dhe çdo informacion i shpërndarë nëpërmjet saj konsiderohet se është marrë nga ana e personelit të Kolegjit BIZNESI.

4. Përdorimi i postës elektronike zyrtare në çdo rast duhet të respektojë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Rregullorja e brendshme e Kolegji BIZNESI përcakton rregulla më të detajuara, për përdorimin dhe mirëmbajtjen e saj.

KREU VII

ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË KOLEGJIN BIZNESI

Neni 51

Format e studimeve

1. Në përputhje me kërkesat ligjore, format e studimit që ofrohen nga Kolegji BIZNESI, janë:

- a) studime me kohë të plotë;
- b) studime pa shkëputje nga puna;

Neni 52

Pranimet për studime

1. Pranohen për të ndjekur studimet në Kolegjin BIZNESI:

a) Qytetarët e Republikës së Kosovës.

b) Studentë të transferuar nga universitete ose shkolla të tjera të larta universitare të vendit apo të huaja;

c) Shtetas të huaj;

2. Pranohen për t'u regjistruar kandidatët që plotësojnë kushtet:

a) Vërtetojnë me dokument zyrtar shtetësinë;

b) Kanë dokument zyrtar të përfundimit të shkollës së mesme në Kosovë ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të vendosura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);

c) Vërtetojnë, me dokument zyrtar aftësinë për të ndjekur studimet e larta;

d) Kanë kaluar provimin pranues.

e) Depozitojnë në sekretarinë mësimore të Fakultetit ose degën përkatëse, kërkesën për t'u pranuar në konkursin e programit që dëshirojnë;

f) Paguajnë tarifën e shkollimit.

3. Kolegji pranon transferime studentësh nga universitetet dhe BAL (publik dhe privat) të tjera. Afati i transferimit të studentëve nga universitetet dhe BAL (publik dhe privat) të tjera në Kolegjin BIZNESI përfundon me fillimin e semestrit dimëror ose verorë. Në këto raste krijohet një komision vlerësimi për masën e ekuivalentimit të programit të studimit pranë degës a programit përkatës me vendim të Dekanit. Pas ekuivalentimit të programit dhe njohjes së notave nga komisioni vlerësues studentit që i plotëson kushtet i njihet e drejta e transferimit, në atë vit akademik si student në Kolegjin BIZNESI.

4. Në Kolegjin BIZNESI mësimi mund të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera.

Neni 53

Organizimi i studimeve me kohë të plotë

1. Programet e studimit në Kolegjin BIZNESI organizohen në dy cikle të njëpasnjëshme:

a) cikli i parë;

b) cikli i dytë.

2. Kolegji BIZNESI ofron programe të integruara të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë së bashku, të cilat realizohen me 300 kredite dhe zgjatja normale e tyre është pesë vite akademike.

Neni 54

Programet e studimit në ciklin e parë

1. Programet e studimit të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi të caktuara në një larmi profesioneve e specialitetesh.

2. Programet e studimit të ciklit të parë në Kolegjin BIZNESI realizohen, si rregull, me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike (për programin juridik me 240 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 4 vite akademike).

3. Studentët në këto programe, mbështetur në kriteret e vendosura në rregulloren e Kolegjit për notën mesatare, mund të diplomohen me punim diplome.

4. Në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, lëshohet diplomë "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 55

Programet e studimit në ciklin e dytë

Programet e studimit në ciklin e dytë organizohen në programe studimi “Master i Arteve”.

Neni 56

Programi i studimit “Master i Arteve”

1. Programet e studimit të ciklit të dytë në “Master i Arteve” i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën “Bachelor”, me njohuri të thelluara shkencore teorike dhe praktike në drejtimin përkatës.

2. Ky program mund të realizohet me 120 kredite me kohëzgjatje normale jo më pak se dy vite akademike (për programin Juridik 60 kredite me kohëzgjatje normale jo më pak se një vit akademik). Këtu përfshihen 30 kredite për një projekt kërkimor, nën udhëheqje të kualifikuar, i cili përfundon me diplomë (mikrotezë). Në përfundim të programit të studimit të ciklit të dytë, lëshohet diplomë “Master i Arteve” në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 57

Hartimi i programeve mësimore

1. Sipas afateve ligjore, programet mësimore hartohen, riorganizohen apo ndryshohen si projekt nga përgjegjësit e programeve në përputhje me kërkesat standarde “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe nga përcaktimet e këtij Statuti.

2. Projekti shoqërohet edhe me argumentimin përkatës, nëse programi i studimit i propozuar ka kosto financiare.

3. Programet e ciklit të parë, janë programe që hartohen dhe riorganizohen në bashkëpunim midis specialistëve në përcaktim të lëndëve sipas fushës së posaçme të secilit. Në këto raste, Dekani ngre komision me një përbërje të barabartë të të gjitha njësive bazë për të integruar vendimmarrjet për pjesët e programeve që i përkasin fushave të tyre të studimit.

4. Në rast miratimi, projekt-programi, nëpërmjet Dekanit, i dërgohet për miratim të mëtejshëm Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor.

Neni 58

Elementët e programeve të lëndës

1. Projekt-programet e përgatitura nga përgjegjësit e programeve organizohen në module dhe në lëndë.

2. Programi i lëndës (Syllabus) hartohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

3. Në hartimin e programeve, përgjegjësit e programeve duhet të shmangin përsëritjen e moduleve të njëjta në cikle të ndryshme të studimit. Për këtë qëllim, nuk mund të ketë përsëritje të temave dhe të bibliografisë së njëjtë në ciklet e ndryshme të studimit.

4. Në çdo rast, literatura dhe materialet e ndryshme që do të përdoren në secilin program studimi dhe në secilën lëndë, duhet të miratohen nga Dekani.

5. Elemente të hollësishme për programet përcaktohen në rregulloren e Kolegjit.

Neni 59

Miratimi i programeve mësimore

1. Me marrjen e propozimit, Dekani ia dërgon për shqyrtim projekt-programin, Komisionit të kurrikulës, i cili, brenda 10 ditëve, harton një raport për Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor, ku shprehet në lidhje me miratimin, kthimin për plotësim apo mosmiratimin e projekt-programit.

2. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor shprehet brenda 30 ditëve për miratimin, kthimin për plotësim, ose mosmiratimin e projekt-programit.

3. Në rast të kthimit për plotësim, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i cakton një afat përgjegjësit përkatës për kryerjen e veprimeve të nevojshme. Kërkesat e Këshillit janë të detyrueshme për përgjegjësin e programit në rishqyrtimin e projekt-programit.

4. Me miratimin e projekt-programit, Dekani ndërmerr masat për përgatitjen dhe dërgimin e Raportit të Vetëvlerësimit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Neni 60

Pajisja me diplomë

1. Me përfundimin e studimeve në Kolegjin BIZNESI fitohen këto diploma: a) Diplomë e ciklit të parë “Bachelor”; b) Diplomë e ciklit të dytë “Master i Arteve”; c) Certifikatë.

2. Me përfundimin e studimeve në Bachelor në Kolegjin BIZNESI, fitohen diplomat me këto tituj:

a) Programi: Banka dhe financa në biznes – Bachelor;

b) Programi: Menaxhment dhe ekonomiks – Bachelor (me nën-programet: Biznes ndërkombëtar, Menaxhim dhe Marketing);

c) Programi: Menaxhimi i Emergjencave – Bachelor (me nën-drejtimet: Mbrojtja nga zjarri, Mbrojtja në punë dhe Mbrojtja e ambientit);

d) Programi: Juridik i përgjithshëm: (LLB) (me nën-drejtimet: Administrative-kushtetuese, Penal-juridik, Civil-juridik, Ndërkombëtare-juridik, Financiare – juridik).

3. Me përfundimin e studimeve Master në Kolegjin BIZNESI, fitohen diplomat me këto tituj:

a) Në Programin: Menaxhment dhe Financa (MA) – Master i Arteve në Menaxhment dhe Financa;

b) Në Programin: Menaxhimit të Emergjencave – (MA) – Master i Arteve në Menaxhimin e Emergjencave;

c) Në Programin Juridik-Penal LLM – Master i Arteve në Juridik – Penal.

4. Për të fituar diplomën studenti duhet të marrë 60 kreditë ECTS në vit (180 kredi për studime Bachelor tre vjeçar), respektivisht 240 kredi për studime Bachelor katër vjeçare.

Nëse kandidati nuk kalon në sesionin e parë të mbrojtjes së diplomës, ai ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sesionin e ardhshëm të mbrojtjes.

Për të marrë diplomën e nivelit Master kandidatët duhet të akumulojnë 60 ECTS kredi (programi 1 vjeçar i studimit), respektivisht 120 ECTS kredi (programi 2 vjeçar i studimeve).

5. Studenti që i plotëson të gjitha kërkesat e planit mësimor pajiset me diplomë, listën e notave dhe Shtojcën e Diplomës. Vlerësimi i studentëve shprehet sipas sistemit të ECTS kredive. Studentët që, në përfundim të studimeve të plota, kanë të gjitha notat dhjetë, dekorohen

me “Medalje të Artë” me certifikatën përkatëse; ata që kanë jo më pak se 80% të notave dhjeta e pjesën tjetër nënta, dekorohen me certifikatën “Student i Shkëlqyer”.

Në Kolegj dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni të çdo Programi; për studentët që fitojnë “Medalje të Artë” ose certifikatën “Student i Shkëlqyer”, ceremonia organizohet në nivel të Kolegjit dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Dekani i Kolegjit, në prani të përfaqësuesve të Bordit, profesorëve, administratës, prindërve, shokëve, miqve të studentëve.

Neni 61 Suplementi i Diplomës

1. Të gjitha diplomat e studimeve të ciklit të parë e të dytë, të lëshuara nga Kolegji BIZNESI, shoqërohen me Suplementin e Diplomës, i cili hartohet në përputhje me udhëzimin e Ministrit përgjegjës për arsimin dhe këtë statut.

2. Suplementi i Diplomës përmban informacionin e mëposhtëm:

I. INFORMACION PËR TË DIPLOMUARIN

1.1. Mbiemri;

1.2. Emri;

1.3. Datëlindja (dita. muaji. viti);

1.4. Numri i amzës i studentit.

II. INFORMACION PËR DIPLOMËN

2.1. Emërtimi i diplomës dhe titulli që i jepet të diplomuarit;

2.2. Fusha/t kryesore e/të studimeve;

2.3. Emërtimi dhe statusi i institucionit që lëshon diplomën;

2.4. Emërtimi dhe statusi i institucionit që administron procesin e studimeve, nëse është i ndryshëm nga ai i parashikuar në 2.3;

2.5. Gjuha në të cilën janë zhvilluar studimet.

III. INFORMACION PËR CIKLIN (NIVELIN) E PROGRAMIT STUDIMOR

3.1. Cikli (niveli) i programit;

3.2. Kohëzgjatja e programit;

3.3. Kriteret e përzgjedhjes në hyrje.

IV. INFORMACION PËR PËRMBAJTJEN E PROGRAMIT DHE REZULTATET

4.1. Sistemi (mënyra e studimit);

4.2. Veçoritë akademike të programit;

4.3. Detaje në lidhje me programin, përfshirë lëndët e studiuara dhe notat dhe kreditet e marra nga i diplomuari;

4.4. Titulli i marrë në përfundim të programit.

V. INFORMACION PËR QËLLIMIN E PROGRAMIT

5.1. Mundësitë për arsim të mëtejshëm;

5.2. Statusi profesional i të diplomuarit.

3. Informacioni i mësipërm organizohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë sipas formatit të suplementit të diplomës, i cili përcaktohet në Rregulloren e Kolegjit BIZNESI.

KREU VIII KËRKIMI SHKENCOR

Neni 62 Veprimtaritë e kërkimit shkencor

1. Kolegji BIZNESI kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuar, studime, ekspertizë shkencore, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e vendit.
2. Kërkimi shkencor realizohet në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarisë së Kolegjit, si dhe fushat parësore të identifikuara prej tij.
3. Kolegji, në fillim të çdo viti akademik përcakton fushat, drejtimet, vëllimin e punës dhe afatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore, me përjashtim të rasteve kur ka plane afatmesme dhe afatgjata për kërkimin shkencor.
4. Të drejtën për të realizuar veprimtari kërkimore-shkencore e kanë personeli akademik dhe studentët.

Neni 63 Revista shkencore

1. Kolegji BIZNESI ka revistën e tij shkencore, e cila do të pasqyrojë zhvillimet më të fundit kërkimore-shkencore të Kolegjit. Ato mund të shërbejnë edhe si pjesë e bibliografisë për lëndët mësimore që jepen në njësitë e degët e Kolegjit.
2. Revista është njohur nga ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe është e pajisura me ISSN. Revista është në format letër dhe në format elektronik. Revista në format letër dy kopje në secilin numër të shtypur, duhet të dorëzohen në Bibliotekën e Kosovës në Prishtinë.
3. Studentët kanë të drejtë të kenë revistë të tyre shkencore në nivel Kolegji. Në pamundësi, ata kanë të drejtë të kenë hapësirën e tyre në revistën e Kolegjit.
4. Mënyra e organizimit, funksionimit, financimit të revistës, bordit shkencor dhe redaksisë rregullohen në mënyrë të veçantë nga rregullorja e botimeve të Kolegjit.

Neni 64 Konferencat shkencore

1. Në përmbushje të funksioneve lidhur me kërkimin shkencor, Kolegji, veç ose në bashkëpunimin me institucione të tjera, realizojnë konferenca shkencore, simpoziume, tryeza shkencore apo seminare të ndryshme.
2. Materialet e konferencave duhet të botohen në mënyrë të përshtatshme, në format letër ose në format elektronik, si dhe të pajisen me ISBN. Kjo nuk zbatohet për aktet e konferencave shkencore që botohen në revistën shkencore.

Neni 65 Botimet mësimore dhe shkencore

1. Kolegji BIZNESI ka shtëpinë Botuese dhe ka të drejtë që të botojë tekste dhe libra, të cilët shtjellojnë njohuri të lidhura me programet e lëndëve që ofrohen në ciklet e studimeve.

2. Këto tekste mësimore shkencore botohen nën drejtimin dhe kujdesin e Kolegjit, në rastet kur ato përmbushin kriteret përkatëse shkencore.

3. Botimi i teksteve shërben si literaturë bazë dhe për të plotësuar literaturën shkencore me njohuri praktike dhe teorike në ndihmë të studentëve dhe të profesionistëve.

4. Të drejtën për botim e kanë të gjithë anëtarët e personelit akademik. Në rastet kur punimi ka vlera të rëndësishme teorike dhe praktike, të drejtën për botim e kanë dhe profesionistë të tjerë.

5. Miratimi i botimeve bëhet nga një komision shkencor që ngrihet pranë Kolegjit.

6. Për këtë qëllim, nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor hartohet dhe miratohet rregullorja e botimeve, në të cilën përcaktohen kriteret shkencore që duhet të plotësojë një dorëshkrim, për t'u botuar nga Kolegji BIZNESI.

7. Kolegji BIZNESI, ka të drejtën e bashkëpronësisë intelektuale dhe për botimet, kërkimet, novacionet dhe veprimtarit e tjera të krijuara nga personeli dhe studentët.

8. Kolegji ka të drejtë të ketë në arkivin e tij të gjithë punën shkencore, ligjërata të autorizuara, shkrime e tekste të tjera, të cilat janë krijuar nga të punësuarit e tij gjatë kohës që ata kanë qenë të punësuar në Kolegj.

Neni 66

Biblioteka e Kolegjit

1. Në Kolegj organizohet dhe funksionon biblioteka.

2. Misioni dhe qëllimi i bibliotekës është që të mbështesë me literaturë mësimore dhe shkencore, aktivitetin e personelit akademik, studentëve, profesionistëve, si edhe kërkuesve shkencorë në përgjithësi.

3. Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit, bazuar në kërkesat e personelit akademik, propozimit të përgjegjësit të bibliotekës dhe të miratuara nga dekani.

KREU IX STUDENTËT

Neni 67 Studentët

1. Student është çdo person fizik shtetar i Kosovës, shqiptar ose i huaj i përfshirë në një program studimi në një nga programet e studimit të Kolegjit BIZNESI, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe ky Statut.

2. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një nga njësitë a degët kryesore të Kolegjit. Ai humbet kur studentit merr diplomën ose certifikatën përkatëse, apo çregjistrohet nga Kolegji.

3. Çdo student është i detyruar të regjistrohet dhe të ndjekë vetëm një program studimi. Përjashtimisht, nxënësit e shkëlqyer dhe studentët e shkëlqyer mund të ndjekin maksimalisht deri në dy programe studimi në të njëjtën kohë.

4. Të dhënat e studentëve ruhen dhe përpunohen nga Kolegji dhe njësitë e degët kryesore, në përputhje me parimin e besueshmërisë dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Studentët janë të detyruar të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga planet mësimore, të parapara nga ky Statut, Rregulloret si dhe çdo akt ligjor apo nënligjor për arsimin e lartëqë eaplikon kolegji. Ata duhet të njohin me hollësi të gjitha detyrimet e të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre. Kolegji nuk mban përgjegjësi për pasojat që rrjedhin nga mosnjohja e tyre.

6. Studenti duhet të respektojë kodin etik të Kolegjit.

Neni 68

Të drejtat e studentëve

Studentët gjatë ndjekjes së studimeve në Kolegjin BIZNESI kanë këto të drejta:

1. Të përfaqësohen në organet e Kolegjit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

2. Të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së Kolegjit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.

3. Të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me programin e studimit që ata po ndjekin.

4. Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash, laboratorë, mjedise sportive dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni.

5. Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë.

6. Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi, si dhe shpërblime të tjera veçanta që administrohen nga Kolegji BIZNESI.

7. Të pajisen me diplomë, ose certifikatë në përfundim të një programi studimi, si dhe me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme.

8. Të marrin pjesë në programe studimi jashtë njësisë kryesore ku studiojnë, të zhvillojnë një apo shumë semestra jashtë Kolegjit, si dhe t'u njihen kreditet dhe lëndët e zhvilluara.

9. Të zhvillojnë praktika mësimore, në institucione që kanë marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin apo njësitë e degët kryesore.

10. Të pajisen me Kartën e studentit dhe të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

11. Të organizohen në organizata jofitimprurëse, brenda Kolegjit, duke iu përmbajtur përcaktimeve të legjislacionit në fuqi

Neni 69

Detyrimet e studentëve

Studentët kanë këto detyrime:

1. Të zbatojnë Statutin dhe Rregulloren në fuqi të Kolegjit.

2. Të respektojnë Kodin e Etikës, të përcaktuar në statutin ose në rregulloren e Kolegjit.

3. Të sillen me korrektësi dhe të respektojnë të drejtat e personelit akademik dhe administrativ, si dhe të studentëve të tjerë.

4. Të përmbushin në kohën dhe afatet e caktuara, si dhe me cilësi, të gjitha detyrimet që rrjedhin nga programi i studimit dhe të marrin pjesë në gjithë veprimtaritë akademike që realizohen nga njësitë kryesore.

5. Të paguajnë tarifën e studimit dhe të shërbimeve të tjera në Kolegj.

Neni 70

Pezullimi i studimeve

1. Çdo student ka të drejtë të pezullojë studimet e tij dhe t'i rifillojë ato në çdo kohë. Pezullimi nuk mund të jetë me i madh se dyfishi i kohës së studimeve për atë cikël studimi. Pas saj, studenti duhet të nisë nga e para regjistrimin në programin e nisur, sipas rregullave të kohës në fuqi.

2. Me pezullimin e studimeve, atij i pezullohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me programin e tij të studimit. Këto i kthehen me rifillimin e studimeve.

3. Procedurat e pezullimit dhe rifillimit të studimeve përcaktohen në rregulloren e Kolegjit.

Neni 71

Përfaqësuesit e studentëve

Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësuesit e tyre në:

- a) Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor,
- b) Këshillin e etikës,
- c) Komisionet e përhershme të lejuara me statut,
- d) Këshillat e studentëve.

Neni 72

Këshillat e studentëve

1. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve të Kolegjit, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të Kolegjit në të gjitha programet e studimit.

2. Këshillat e studentëve nuk zhvillojnë veprimtari politike, ekonomike apo të tjera jo në përputhje me normat e Statutit dhe të etikës.

3. Ata kanë të drejtë të organizohen në nivel Kolegji.

4. Këshillat e Studentëve e mbështesin veprimtarinë e tyre në ligjin nr. 04/L-037 "Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës", në këtë statut si dhe në aktet për organizimin dhe funksionimin e vet këshillave.

5. Këshilli i Studentëve të Kolegjit harton dhe miraton statutin për funksionimin e tij. Këshillat e studentëve të njëjësive bazë hartojnë dhe miratojnë rregulloret për funksionimin e tyre në përputhje me statutin e Këshillit të studentëve të Kolegjit.

6. Këshillat e studentëve të Kolegjit kanë të drejtë:

- a) Të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e Kolegjit dhe njëjësive e degëve kryesore.
- b) Të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimit të Kolegjit, rregulloret për veprimtaritë mësimore, si dhe të drejtën për të studiuar.

c) Të japin opinionet e tyre për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga njësitë kryesore dhe/ ose njësitë bazë.

d) Të organizojnë së bashku me njësitë kryesore ose vetëm veprimtari të ndryshme shkencore, shoqërore, kulturore, artistike, sportive etj.

7. Këshillat e studentëve kanë mandat 2-vjeçar dhe anëtarët e tyre zgjidhen nga votat e të gjithë studentëve të Kolegjit ose njësisë kryesore. Rregullat në lidhje me procesin e votimit përcaktohen në rregulloren përkatëse.

8. Në momentin e nisjes së procesit të ngritjes së strukturave për këshillat e studentëve, duhet të vihen në dijeni autoritetet drejtuese, përkatësisht Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm, nëse janë në nivel Kolegji ose përgjegjësi i degës dhe administratori i njësisë kryesore, nëse janë në nivel dege a njësie kryesore.

9. Pas zhvillimit të zgjedhjeve dhe nxjerrjes së rezultatit, si dhe krijimit të Këshillave të Studentëve, duhet të vihen në dijeni autoritetet drejtuese si më sipër.

Neni 73 Disiplina

1. Për shkelje të rregullave të etikës dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si edhe në këtë statut apo akte të tjera të Kolegjit BIZNESI, studentët mbajnë përgjegjësi disiplinore.

2. Llojet e shkeljeve disiplinore, konstatimi dhe procedimi i tyre rregullohen në rregulloren e Kolegjit.

KREU X SIGURIMI I CILËSISË

Neni 74 Sigurimi i brendshëm i cilësisë në Kolegjin BIZNESI

1. Kolegji harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë së Institucionit në fushën akademike në çdo 6 muaj para përfundimit të semestrave dimëror e veror; në fushën administrative një herë në vit; dhe në fushën financiare një herë në vit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë mund të kryhet i përgjithshëm, ose pjesor. Ai realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:

a) Strukturave hierarkike organizative të brendshme të Kolegjit, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për përmbushjen e vizionit të tij;

b) Komisionit të Përhershëm për Sigurimin të Standardeve të Cilësisë në nivel institucioni, i cili bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel të Kolegjit.

2. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, Kolegji i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Mënyra e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë përcaktohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë së Kolegjit.

Neni 75

Parimet e funksionimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë

1. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetet në:
 - a) Garantimin e transparencës, e cila realizohet përmes publikimit të raporteve me gjetjet periodike për vlerësimet student-personel akademik, përgjegjës programi - personel akademik;
 - b) Mbajtjen e kontakteve me studentët aktualë dhe alumni, si edhe me punëdhënësit e tyre;
 - c) Vlerësimin e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të mësuarit me qëllim që të promovohet përgatitja e një studenti interaktiv;
 - ç) Krijimin e një kulture të përmirësimit dhe rritjes së vazhdueshme;
 - d) Garantimin e ofrimit të programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të shoqërisë në Kosovë;
 - dh) Garantimin e pjesëmarrjes së personelit akademik dhe të studentëve në procesin e vetëvlerësimit dhe në përfitimin prej ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë.

Neni 76

Funksionet e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë

1. Misioni i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë është garantimi i cilësisë së brendshme të Kolegjit dhe i programeve që ofrohen prej tij, në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Për realizimin e misionit të saj, KPSSC-ja ka në kompetencë:
 - a) Të hartojë planin e zhvillimit institucional për sigurimin e cilësisë dhe ta dërgojë për miratim në Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor;
 - b) Të bëjë vlerësimin për herë të parë të programeve të reja që do të ofrohen, përpara miratimit të tyre në Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor;
 - c) Të bëjë vlerësimin në vazhdimësi të programeve që ofrohen nga Kolegji nëse janë në përputhje me standardet e cilësisë, si edhe koherencën e tyre;
 - ç) Të bashkëpunojë me Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe të bëjë vlerësimin me kërkesën e saj, në rast akreditimi të programeve apo të vlerësimit të cilësisë;
 - d) Të bëjë vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore në njësitë kryesore/degët e Kolegjit, në përputhje me standardet e cilësisë dhe të hartojë raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm;
 - dh) Të ndjekë politikat e hartuara nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor për sigurimin e cilësisë dhe të marrë masat e duhura për të zbatuar vendimet e tij;
 - e) Të hartojë dhe të organizojë çdo fund semestri për studentët pyetësorin për cilësinë e mësimdhënies në të gjitha programet që Kolegji ofron;
 - ë) Të realizojë studime gjurmuese lidhur me ecurinë e punësimit të studentëve pas formimit të tyre akademik dhe efikasitetin e programeve të ofruara;
 - f) Të raportojë përpara Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor për rezultatet e vlerësimit dhe të bëjë propozime në lidhje me përmirësimin e standardeve të cilësisë;

g). Të bashkëpunojë me agjenci të huaja të sigurimit të cilësisë, që janë anëtare të Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA).

2. KPSSC mblidhet dhe funksionon sipas parimeve dhe rregullave të parashikuara në këtë Statut dhe në Rregulloren e tij.

3. Në mbledhjen e parë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë zgjedh kryetarin dhe sekretarin e tij. Kryetari drejton mbledhjet e komisionit dhe nënshkruan në emër të komisionit aktet që ai nxjerr.

KREU XI FINANCIMI I KOLEGJIT

Neni 77 Financimi iKolegjit

1. Kolegji BIZNESI është institucion jo publik i arsimit të lartë dhe financohet nga themeluesi i Kolegjit.

2. Ndarjen e buxhetit sipas zërave, e shqyrton dhe miraton Bordi i Kolegjit.

3. Kolegji ka të drejtë të krijojë e të përdorë të ardhura nga tarifatat e studentëve, veprimtaritë kryesore e dytësore e nga bashkëveprimi me të tretet, vendas ose të huaj.

4. Të ardhurat e krijuara nga tarifatat e shkollimit ndahen me vendim të posaçëm të Borditkolegjit.

5. Kolegji paguan rregullisht taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe palës së tretë. Pjesa që mbetet përbën fitimin e tij.

6. Veprimtaria ekonomike e Kolegjit pasqyrohet në bilanci e tij, tremujore, gjashtëmujor dhe vjetore.

Neni 78 Autonomia financiare

1. Kolegji BIZNESI funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.

2. Ai harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit. Secili program, brenda datës 15 korrik, paraqet në Dekanat projektbuxhetin e tij për vitin pasardhës.

3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga Kolegji përdoren prej tij sipas ndarjeve që bën pronari.

Neni 79 Raportimi

1. Kolegji BIZNESI i paraqet, çdo vit akademik, ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifatat e shkollimit për vitin në vijim, informacion për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program

studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës, sipas afateve që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

KREU XII NDRYSHIMI I STATUTIT

Neni 80 Procedura e ndryshimit të statutit

1. Të drejtën e nismës për propozimin e ndryshimeve në Statutin e Kolegjit BIZNESI e kanë:

- a) jo më pak se pesë anëtarë të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor;
- b) jo më pak se dy anëtarë të Bordit;
- c) jo më pak se njëzetepesë anëtarë të personelit akademik të Kolegjit;
- ç) Dekani.

2. Propozimi duhet të shoqërohet me një relacion në të cilin të shpjegohen: qëllimi i ndryshimeve, përparësitë që ato sjellin, kostot financiare, nëse ka dhe çdo e dhënë tjetër që i shërben procesit të ndryshimeve në Statut.

3. Propozimi i paraqitet Dekanit, i cili ia kalon për konsultim të gjithave njërive bazë të Kolegjit. Ky proces konsultimi nuk mund të jetë më pak se 30 ditë.

4. Me përfundimin e procedurës së përcaktuar në pikën 3, Dekani propozimin fillestar, relacionin përkatës dhe propozimet e sjella nga njësitë bazë ia përcjell për vendimmarrje Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, i cili vendos sipas kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”.

5. Në rast se Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor kërkon të bëjë ndryshime në tekstin e miratuar nga Bordi, ia përcjell përsëri atij me ndryshimet përkatëse.

6. Në rast se ka mosmarrëveshje midis Bordit dhe Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, atëherë ngrihet një grup pune i përbërë nga katër anëtarë, dy nga secili organ, i cili ndërmerr hartimin e një teksti të përbashkët.

Neni 81 Hartimi i akteve të reja

Brenda 12 muajve nga miratimi i këtij Statuti, organet përkatëse hartojnë dhe miratojnë rregulloren e brendshme të Kolegjit BIZNESI dhe rregulloret e organeve drejtuese dhe të njërive kryesore, Kodin e etikës dhe akte të tjera të nevojshme për zbatimin e këtij statuti.

Neni 82 Riorganizimi

Brenda 12 muajve nga miratimi i këtij Statuti, njësitë e Kolegjit BIZNESI, riorganizohen, aty ku është nevoja, në përputhje me kërkesat e këtij Statuti.

Neni 83
Hyrja në Fuqi e këtij statusi

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga Kryetari i Bordit.

Prof. Dr. Reshat Kadriu

Kryetar i Bordit